



## Titulli i projektit

Ndërtimi i murit rrethues dhe krijimi i mjediseve të përshatshme në shkollën e mesme dhe 9- vjeçare në qytetin e Bajram Currit

## Tipi i projektit

Zhvillimi ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt

## Vendndodhja e projektit

Bajram Curri

## Buxheti i paravlerësuar

150,000 Euro

## Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Shkolla e mesme e qytetit Bajram Curri është shkolla më e madhe në zonën funksionale Tropojë. Në të ndjekin shkollën rreth 700 nxënës dhe punojnë 45 mësues. Pranë saj ndodhet shkolla 9-vjeçare "Ali Podrimja", e cila është ndërtuar në vitin 2012 dhe çdo vit frekuentohet nga rreth 500 nxënës dhe 30 mësues. Të dyja shkollat, ndodhen në një territor të përbashkët, i cili nuk është i rrethuar me mur rrethues. Shkolla e mesme nuk siguron kushte të përshatshme për procesin mësimor dhe edukativ të nxënësve. Një nga problemet kryesore, përveç murit rrethues është çatia e dëmtuar, e cila pikon vazhdimisht gjatë periudhës së dimrit. Gjithashtu, oborri i shkollës nuk ka kushtet minimale të një mjedisi për edukimin e nxënësve. Këndet sportive janë jashtë funksionimit, nuk ka gjurmë të mjediseve të mëparshme sportive për shak të mungesës së mirëmbajtjes së tyre. Shkolla 9-vjeçare nuk ka ofruar qysh në fillim një mjedis të përshatshëm për pushimet e nxënësve ndërmjet orëve mësimore dhe ato sportive. Shpesh, mjediset jashtë shkollës frekuentohen nga persona të tjerë dhe është e pamundur mbajtja në kontroll e tyre. Për rrjedhojë, ka patur raste të konflikteve ndërmjet të rinjve dhe personave jashtë shkollës, apo fenomene të tjera negative, si përdorimi i cigares, drogës, etj.. Shkolla e mesme mbledh nxënës edhe nga komunat Margegaj, Bujan e Tropoja fshat, Llugaj etj., pasi është në preferencën e tyre për të studiuar në qytet. Rrethimi i oborrit dhe krijimi i mjediseve të përbashkëta, të përshatshme, sportive dhe çlodhëse, për nxënësit dhe mësuesit do të ulë rrezikun e ndërhyrjeve nga jashtë dhe do të krijojë një mjedis të kulturuar në shkollë. Projekti është në përputhje me studimin e zonës funksionale Tropjë përsa i përket përmirësimit të kohezionit social të komunitetit.

## Qëllimi/et specifik të projektit

Objektivat specifikë të projektit përfshijnë:

1. Krijimi i një mjedisi të përshatshëm për procesin mësimor, edukativ dhe sportiv për nxënësit e dy shkollave, respektivisht shkollës së mesme dhe shkollës 9-vjeçare "Ali Podrimja" në qytetin e Bajram Currit
2. Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe personelit mësimdhënës për mirëmbajtjen e mjediseve të krijuara dhe luftës kundër fenomeneve negative, si konflikti, droga dhe trafikimi njerëzor.

# PROJEKTI 8



program i zonave funksionale

# pzf

## Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme të projektit, bazuar në objektivat e mësipërme përfshijnë:

1. Mjedis fizik i sigurtë për të dy shkollat;
2. Çatia e shkollës së mesme e rikonstruktuar;
3. Infrastrukturë e përmirësuar e oborrit dhe këndit të shkollave;
4. Të rinj të sensibilizuar për mirëmbajtjen e mjedisit të krijuar.

Përfituesit e projektit përfshijnë 1200 nxënës të dy shkollave, 75 mësues dhe komunitetin në tërësi të 4 njësiave vendore, përfshirë Bajram Currin, Margegajn, Bujanin, Llugajin, Tropojën fshat, etj.

## Aktivitetet e projektit

Aktivitetet kryesore për realizimin e objektivave dhe rezultateve të pritshme përfshijnë:

1. Ndërtimi i murit rrethues dhe sistemimi i mjedisit;
2. Riparimi i çatisë së ndërtesës së shkollës së mesme;
3. Ndërtimi i mjediseve sportive;
4. Fushatë ndërgjegjësuese me nxënësit e shkollave të projektit për mirëmbajtjen e mjedisit dhe luftën kundër fenomoneve negative, si konflikti/drogat/trafikimi njerëzor.

Periodha e realizimit të projektit është 6 muaj.

## Maturimi i projektit

Propozimi është në fazën e një projekt ideje.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Projekti përfshihet në funksionet e përbashkëta të bashkisë. Ai do të zbatohet nga bashkia Bajram Curri në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore.

Financuesit përfshijnë: Bashkinë Bajram Curri, Drejtorinë Arsimore, komunitetin e nxënësve dhe mësuesve.

## Kostot e projektit

Vlera e projektit do të jetë 150,000 Euro.